



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr. 189/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) paraqitur kundër Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 27.01.2025, mori këtë:

### V E N D I M

**Hedhet e palejuar ankesa e parashtuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) A.nr.189/2025 e datës 24.01.2025, paraqitur kundër Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.**

### A r s y e t i m

Me datën 24.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendohet se me 23 Janar 2025 Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Suharekë ka identifikuar banerë/posterë të vendosura në hapësirat/rrugë publike të kandidates për deputete të AAK-së Albana Bytyqi në rrugët publike “Brigada 123” në Suharekë . Këta banerë/posterë janë vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës”. Si provë ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerëve/Posterëve në kundërshtim me LPZ.

Më datë 25.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 26.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 26.01.2025, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet ankimore

të paraqitura nga LVV, ngase ato janë të pabazuar dhe nuk provojnë inkriminimin e këtij subjekti në shkeljet e pretenduara. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se fillimisht kontestojmë afatshmerinë e ankesës ngase ajo nuk është bërë brenda afatit të paraparë ligjor, dhe se ajo edhe po të ishte e afatshme përsëri do të ishte e pabazuar duke shtuar faktin se gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë ato veçse janë larguar dhe se kandidatja për deputete znj. Bytyqi në kohën kur i kishte vendosur posterët kishte vepruar në harmoni me nenin 44, paragrafi.1, nën paragrafi 1.2 i LZP-së si dhe në pajtim me Rregulloren për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024, neni 5, paragrafin 1.2 të kësaj rregullore.

Në këtë drejtim, sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë duke vlerësuar që misioni i PZAP është fuqizimi i demokracisë, paanshmëria dhe zgjedhja e kontesteve zgjedhore në kohë për te siguruat të drejtat e të gjithë akterëve ne procesin zgjedhor, atëherë është më se jetike hedhja poshtë e gjitha pretendimeve ankimore të subjektit politik LVV, duke potencuar Nenin 117.3 të LPZ-së i cili përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkangjitur foto dëshmitë nga vendi i ngjarjes.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën Anr.166/2025 të paraqitur me datën 23.01.2025 nga po i njëjti subjekt politik LVV, kundër të njëjtit Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, përkatësisht kandidatet për deputete Albana Bytyqi, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.166/2025 të datës 26.01.2025 Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.166/2025 të datës 26.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesë.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115.1 dhe 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 189/2025 më datën 26.01.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.